

*Dokumentacioni i nevojshëm për pajisjen me leje për prishje objekti nga autoriteti vendor*

- Referuar **Ligjit 107/2014 datë 01.10.2014** “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 29, përcakton se, *Kryetari i bashkisë është përgjegjës për vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë.*
- Në **VKM Nr. 408, Datë 13.5.2015**, “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar me **VKM nr. 271, datë 06.04.2016**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, **VKM nr. 231, datë 21.03.2017**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, dhe **VKM Nr. 355, datë 19.04.2017**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, Neni 15, përcakton dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me leje për prishje ndërtimi.

*Për prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri, kërkuesi duhet të paraqesë kërkesë të veçantë. Dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t’u pajisur me leje për prishje ndërtimi janë, si më poshtë vijon:*

- a) *Kërkesa për leje ndërtimi, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve;*
- b) *Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të kërkuetit mbi objektin që kërkohet të priset;*
- c) *Raporti teknik i ekspertëve për gjendjen fizike dhe ndërtimore të objektit që do të priset;*
- ç) *Mandatpagesën/at e tarifës/ave të aplikimit.*